

Soreca takon kryetaren e KLGJ: Ngritja e Gjykatës së Lartë, prioritet kryesor



Ambasadori i BE Luigi Soreca deklaroi se ngritja e Gjykatës së Lartë mbetet një prioritet kryesor.

Në një postim në Twitter, pas takimit me kryetaren e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Naureda Llagami, Soreca u shpreh:

“U takova sot me kryetaren e KLGJ-së, Naureda Llagami. Këshilli luan një rol kyç në sistemin e ri të drejtësisë. Mbushja e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë mbetet prioritet kryesor. BE mbështet Këshillin në përpjekjet e tij për rritur efikasitetin dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor.”